

PROCESVERBAL
nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 23.04.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 12:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.04.2024.
2. Shqyrtimi i raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 janari deri më 31 mars 2024.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup për shkelje të nenit 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.04.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Petrushevski, në lidhje me Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 janari deri më 31 mars 2024, shpjegoi se Këshilli nuk i voton, por i jepet si informim anëtarëve të Këshillit për aktivitetet aktuale të zbatuara të Agjencisë. Për shkak se koha për shqyrtimin e raporteve ishte e shkurtër, në konsultim me Këshillin, pika u shty (anulua) për fillimin e seancës së ardhshme.

Pika 3

Z. Trajçeovski shpjegoi propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup për shkelje të nenit 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit zgjedhor. Ai shpjegoi se me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, transmetuesit në nivel kombëtar janë të detyruar të transmetojnë një edicion lajmesh në periudhën nga ora 16:00 deri në orën 24:00, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe një emision tjetër informativ gjatë javës. Nga mbikëqyrja u konstatua se ky transmetues nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor. Ai tha se në Raport gjithçka është e detajuar dhe nëse ka nevojë për pyetje, përgjigjet do t'i japin udhëheqësit e Sektorit për Çështje Programore.

Z. Petrushevski tha se për të nuk ka nevojë për shpjegime shtesë. E ka ndjekur komunikimin me median, e di që ka bërë premtime se do ta bëjë këtë, por mesa duket për arsye teknike dështoi. Ai tha se ndoshta media ka gjëra më të rëndësishme për të bërë në këtë moment si mbulimi i zgjedhjeve dhe reklamimi politik me pagesë. Ai ka shpjeguar se Kodi Zgjedhor duhet respektuar dhe në këtë drejtim ka pyetur anëtarët e Këshillit nëse dëshirojnë që në seancë të transmetohen regjistrimet nga programi i këtij televizioni si provë e shkeljes së kryer.

Z. Ajdini në lidhje me shkeljen tha se këto ditë ka qenë në komunikim me redaktorin e SHTR "KLAN MAQEDONI" dhe me udhëheqësen e Sektorit për Çështje Programore. Sipas tij, është evidente se transmetuesi ka problem teknik, por shihet se janë të përkushtuar që këtë obligim të Ligjit ta përmbushin. Ai deklaroi se donte t'i shikonte regjistrimet e programit të televizionit TV KLAN.

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi siç thuhet në materialet se TV Klan më 2 prill e ka njoftuar Agjencinë se çdo ditë të procesit zgjedhor do të transmetojë një edicion lajmesh në ora 20:00, dhe të premtën në orën 19:50 me titrim në gjuhën e shenjave, si dhe një emision special "Zgjedhjet 2024 - Debate" në bazë javore të përshtatur me titra i cili do të transmetohet çdo të diel në orën 19:15. Nga mbikëqyrja për të gjithë periudhën e fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale nga 4 prilli deri më 22 prill, u konstatua se televizioni nuk transmetoi lajme në orën 20:00 dhe të premtëve në orën 19:50 siç dhe deklaroi në njoftimin e dorëzuar në Agjenci, por lajmet janë transmetuar rreth orës 18:30 dhe rreth orës 22:00. Në disa nga edicionet e lajmeve të transmetuara në pjesën

e poshtme të ekranit lëvizte një kiron me informacion, por ky informacion ndryshonte krejtësisht nga përmbajtja e përmbledhjeve që transmetoheshin në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, kjo nuk mund të konsiderohet për përshtatje të lajmeve për personat me aftësi të kufizuara. Sa i përket emisionit special të paralajmëruar "Zgjedhjet 2024 – Debate" i cili sipas njoftimit të televizionit është dashur të transmetohet çdo javë në orën 19:15, nga mbikëqyrja në periudhën prej 4 deri më 22 prill, nuk është regjistruar transmetimi i saj dhe aspak nuk është regjistruar transmetimi i debateve të dielën siç ishte paralajmëruar në shkresën e 2 prillit. Nga ana tjetër, gjatë ditëve të javës gjatë gjithë periudhës së analizuar është regjistruar transmetimi i disa emisioneve debatuese, madje në dy prej emisioneve debatuese, njëri i transmetuar më 9 prill dhe tjetri më 16 prill, është konstatuar tentativ nga transmetuesi t'i përshtat ato te personat me dëmtime shqisore. Në këto dy emisione është përdorur softuer të fjalës në tekst, por ai ishte i cilësisë së dobët, softueri nuk arriti të transmetonte të gjithë përmbajtjen, ishte shumë i vonuar, përsëriste të njëjtat fjalë shumë herë, etj. Në të njëjtën kohë, madhësia e shkronjave ishte shumë e vogël për tu ndjekur përmbajtja nga personat me aftësi të kufizuara. Ai bëri të ditur se tani do të transmetohet një fragment nga lajmet për të parë se në çfarë forme po transmetohen lajmet, e më pas do të vijon një klip nga debati i 9 prillit në të cilin televizioni u përpoq ta bënte atë të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.

Në seancë janë lëshuar inçizimet e programit, mbi të cilin është bërë Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor dhe është konstatuar shkelje.

Udhëheqësja Janevska shpjegoi se nga regjistrimi rezulton se teksti i kyronit, për të cilin media mendonte se mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit, nuk përputhet me përmbajtjen e lajmeve. Prandaj, nuk mund të pranohet si përshtatje e përmbajtjes për personat me aftësi të kufizuara. Kajronë të tillë rregullisht emetohen dhe nga transmetues të tjerë në kuadër të shumë emisioneve informative.

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova shpjegoi se përpjekje për të përshtatur përdorimin e softuerit që e konverton fjalimin në tekst, por teksti që shkon në kajron (tastierë) nuk i referohet përmbajtjes së asaj që prezantuesi flet, këto janë disa komente nga më parë dhe përsëritje fjalësh. Kur fjalimi fillon të kthehet në tekst, ai tashmë vonon. Ajo ka shpjeguar se 4-5 ditët e para të fushatës janë bërë ndërprerje për shkak se ky detyrim për herë të parë po futet dhe është detyrim i ri për transmetuesit dhe menjëherë u është dërguar shkresë të gjithë transmetuesve sepse shumica e tyre kanë pasur probleme me cilësinë, mënyrën se si e kanë përmbushur këtë detyrim, ndërsa TV KLAN në përgjithësi në atë periudhë nuk ka bërë asnjë përpjekje për të bërë ndonjë përshtatje në debat.

Z. Petrushevski tha se në bazë të diskutimit dhe video-materialeve që janë transmetuar dhe shpjeguar do të mbështesë propozimin e shërbimit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor nr.10-2007/1 të datës 23.04.2024 të SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor.

Këshilli njëzëri ka konkluduar kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP EXPORT-IMPORT - SARAJ, SHKUP që të inicojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se në kundërshtim me nenin 75 paragrafi (1), dhe në lidhje

me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor, në periudhën nga 4 deri më 22 prill 2024, televizioni nuk ka ofruar informacion për procesin zgjedhor në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, pra duke përdorur gjuhën e shenjave, titrat, përshkrimin audio apo mjete të tjera për të siguruar aksesueshmërinë, madje as në të paktën një edicion të lajmeve në baza ditore, e as në ndonjë përmbajtje tjetër programore në baza javore të transmetuar në periudhën nga ora 16:00 deri në orën 24:00, gjatë fushatës zgjedhore për rrethin e parë të Zgjedhjeve presidenciale, megjithëse publikonte reklamim të paguar politik në vazhdimësi gjatë fushatës zgjedhore.

Spektori për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**